

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LIBRAZHD  
KËSHILLI BASHKIAK

**VENDIM**

**Datë.29.05.2026**

Nr.3155 prot

**Nr.59 dt.26.05.2026**

**“Për Miratimin e Raportit të Performancës 2025”**


“Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 ‘Për vetëqeverisjen vendore’, i ndryshuar, veçanërisht dispozitat që lidhen me sistemin e administrimit dhe matjes së performancës, të ligjit nr. 68/2017 ‘Për financat e vetëqeverisjes vendore’, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 ‘Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar, si dhe në kuadër të Sistemit të Matjes së Performancës së Bashkive (SMP), propozohet miratimi i Raportit të Performancës për vitin 2025.”Këshilli Bashkiak i mbledhur sot më datë 26.05.2026 dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd:

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Raportin e Performancës së Bashkisë Librazhd për vitin 2025.
2. Ngarkohet Drejtoria e Integritimit, Projekteve me BE, Migracionit, Diasporës dhe Performancës për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETAR I KËSHILLIT  
**Elson MALLUTA**

ZV/KRYETARE E KËSHILLIT  
**Silvana HOXHA**





Ky raport është hartuar me mbështetjen e projektit Bashki të forta, projekt i Agjensisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (Ambasada e Zvicrës në Shqipëri, Organizata për Zhvillim dhe Bashkëpunim e Zvicrës) dhe Qeverisë së Suedisë (Ambasada e Suedisë në Shqipëri) I zbatuar nga Helvetas. Projekti ka si synim kryesor që qytetarët shqiptarë të përfitojnë nga përmirësimi i qeverisjes dhe i shërbimeve në nivel vendor sipas standarteve minimale dhe të përballueshme të miratuara për një sistem të qëndrueshëm në vend.

## PËRMBAJTJA

Fjalor Shpjegues .....	7
Qellimi I Raportit .....	8
Vështrim i Përgjithshëm mbi Bashkinë .....	9
Të Dhënat e Përgjithshme të Bashkisë .....	10
SHERBIME PUBLIKE VENDORE .....	11
📖 Arsimi Paraniversitar .....	19
🏠 Menaxhimi i Mbetjeve .....	23
🔥 Mbrojtja nga zjarri .....	26
🗑️ Administrimi i pyjeve dhe kullotave .....	30
👥 Mbrojtja Sociale .....	34
QEVERISJA E MIRE .....	35
👤 Burimet Njerëzore .....	39
📄 Transparenca .....	42
EU Integrimi në BE .....	45
MENAXHIMI FINANCIAR .....	51
Menaxhimi i Infrastruktures se Ujitjes dhe Kullimit .....	52

# FJALOR SHPJEGUES

## **Disagregim**

Është procesi i ndarjes së të dhënave sipas kategorive të veçanta (si gjinia, mosha, vendbanimi urban/rural, tipi i institucionit publik/privat etj.) me qëllim që të kuptohet më mirë shpërndarja dhe ndikimi i një shërbimi ose fenomeni. Disagregimi ndihmon për të evidentuar pabarazitë, për të krahasuar grupet e ndryshme dhe për të planifikuar politika apo ndërhyrje më të drejtuara dhe gjithëpërfshirëse.

## **Funksion**

Është fusha e veprimtarisë, për të cilën njësia e vetëqeverisjes vendore është përgjegjëse dhe ka kompetencën ligjore për ta ushtruar lirisht, tërësisht apo në një pjesë të tij, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore

## **Nën-Tregues**

Një nën-tregues është një element më i detajuar i një treguesi kryesor, që shërben për ta shpërbërë dhe matur më saktësisht një aspekt të veçantë të tij. Nën-treguesit ndihmojnë në kuptimin më të thelluar të performancës, duke dhënë informacion të ndarë sipas gjinive, zonave gjeografike, llojit të shërbimit (publik/privat) apo kritereve të tjera të disagregimit.

## **Produkt**

Një produkt i realizuar nga bashkia i referohet një të mire materiale ose shërbimi që ofrohet nga bashkia, e cila është përgjegjëse për ofrimin e shërbimit apo të mirës materiale. Bashkitë sipas ligjit janë përgjegjëse për ofrimin e një game të gjerë shërbimesh publike, si transporti, kanalizimi, furnizimi me ujë, menaxhimi i mbetjeve, shërbimet e mbrojtjes nga zjarri dhe asaj civile etj.

## **Qeverisja e Mirë**

I referohet parimeve dhe praktikave që garantojnë funksionimin efikas, transparent, gjithëpërfshirës dhe të drejtë të një bashkie. Në këtë kuadër përfshihen elementë si transparenca publike, barazia gjinore, integrimi në BE, pjesëmarrja qytetare, profesionalizmi i burimeve njerëzore dhe menaxhimi i qëndrueshëm financiar.

## **Sistemi i Matjes së Performancës**

Është mekanizmi kombëtar dhe vendor për mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave mbi ofrimin e shërbimeve nga bashkitë. Ky sistem përfshin një grup treguesish dhe nën-treguesish të standardizuar, që përdoren për të krahasuar performancën e bashkive, për të

rritur transparencën, llogaridhënien dhe për të mbështetur vendimmarrjen e bazuar në evidencë.

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 33, çdo bashki është e detyruar të krijojë një sistem të brendshëm matjeje dhe raportimi mbi performancën e saj, në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike, përdorimin e burimeve dhe realizimin e objektivave. Ky sistem vendor lidhet ngushtë me sistemin kombëtar, duke mundësuar harmonizimin e të dhënave dhe krahasimin mes njërive të vetëqeverisjes vendore.

### **Sherbime Publike Vendore**

Janë shërbimet që ofrohen nga bashkia për komunitetin, në përputhje me funksionet e përcaktuara nga ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Këto përfshijnë, ndër të tjera, , ndriçimin publik, arsimin parashkollor dhe cerdhet, mbrojtjen sociale, menaxhimin e mbetjeve, pyjeve e kullotave dhe ujitjen dhe kullimin etj. Sipas perkufizimit the ligjit "janë ato shërbime me interes të përgjithshëm publik, të cilat ofrohen për komunitetin nga bashkitë, në mënyrë të vazhdueshme, me çmime të përbalueshme, sipas standardeve minimale kombëtare, të përcaktuara me ligj apo me akte të tjera normative'

### **Tregues performance**

Një tregues i performancës është një matje që përdoret për të vlerësuar suksesin ose përparimin e një procesi. Mund të përdoret për të gjurmuar arritjet kryesore të performancës, të tilla si performanca financiare, kënaqësia e klientit, produktiviteti i punonjësve ose efikasiteti operacional, ose buxhetor / financiar dhe për të përcaktuar nëse synimet ose objektivat po përmbushen. Treguesit e performancës përdoren shpesh në sektorin privat por edhe ate publik dhe organizata të tjera për të ndihmuar menaxherët të marrin vendime të informuara, të identifikojnë fushat e përmirësimit dhe të masin performancën e përgjithshme të bashkisë.

### **Të Dhëna**

Janë informacionet e mbledhura nga burime zyrtare të bashkisë ose institucione të tjera, që shërbejnë si bazë për llogaritjen e treguesve të performancës. Të dhënat mund të jenë numerike (statistika mbi popullsinë, buxhetin, shkollat etj.) ose cilësore (planifikime, raporte, dokumente strategjike) dhe janë të domosdoshme për analizën dhe raportimin e performancës.

### **Taksat e ndara**

Janë taksa kombëtare që mblidhen nga qeveria qendrore dhe ndahen plotësisht ose pjesërisht me bashkitë

### **Taksat vendore**

Janë detyrime fiskale të bashkisë të cilat paguhet sipas parashikimeve ligjore dhe përcaktimeve të Këshillit Bashkiak

### **Tarifat vendore**

Janë detyrime që individët apo bizneset paguajnë kundrejt marrjes së një shërbimi të ofruar nga bashkia

### **Transfertat e kushtëzuara**

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur vetëm për projekte të veçanta apo funksione të deleguara të bashkisë

### **Transfertat e pakushtëzuara**

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur pa kushte, pa interes dhe pa të drejtë kthimi

### **Transferta e pakushtëzuar sektoriale**






Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë me kushtin për t'u përdorur vetëm për funksione specifike që bashkia i ka marrë nga Qeveria me ligj të veçantë

### **Trashëgimi nga viti i kaluar**

Janë fonde buxhetore të bashkisë të cilat nuk janë shpenzuar në mbyllje të vitit buxhetor të kaluar dhe mund të përdoren në vitin korent buxhetor. Ato mund të jenë me destinacion dhe pa destinacion. Varësisht nga kjo ato mund të përdoren gjatë vitit korent me destinacion të përcaktuar (për ato projekte apo zëra buxhetor specifik për të cilat janë angazhuar gjatë vitit të kaluar por nuk kanë arritur të shpenzohen) apo pa destinacion (për cfarëdo zë apo projekt).

### **Si të lexojmë tabelën e performancës**

Tabelat e treguesve në çdo fushe paraqesin ecurinë e treguesve të performancës për secilën fushë funksionale. Për çdo tregues jepen vlerat për dy vite, ndryshimi ndërvite, trendi, dhe semafori, të cilat ndihmojnë në interpretimin e rezultateve.

Kolona	Përshkrimi
Treguesi	Emri i treguesit që mat një aspekt të caktuar të performancës (p.sh. "Përqindja e konsultimeve publike të zhvilluara").
Njësia matëse	Tregon mënyrën se si matet treguesi (p.sh. %, numër, ha, lekë/frymë).
Vlera 2024 / 2025	Tregojnë rezultatet e arritura për secilin vit.
Ndryshimi (%)	Diferenca në përqindje ndërmjet viteve. Formula: $(\text{Vlera 2025} - \text{Vlera 2024}) / \text{Vlera 2024} \times 100$ .
Trendi dhe Simboli i Trendit (→ ↑ ↓)	Diferenca në vlerë absolute ndërmjet viteve. (Vlera 2025 – Vlera 2024). Simboli i Trendit tregon drejtimin e lëvizjes: ↑ përmirësim, ↓ përkeqësim, → stabilitet
Semafori	Vlerësim vizual i nivelit të performancës:  <ul style="list-style-type: none"> <li> = vlere absolute ndryshimi pozitiv</li> <li> =vlere absolute ndryshimi negative.</li> <li> = nuk ka ndryshim (vlere mbetet e njëjtë)</li> <li> = mungojnë të dhënat (nuk raportohen vlere për një ose të dy vitet).</li> </ul>

Nota metodologjike mbi semaforin dhe interpretimin e treguesve

Në tabelat e performancës, ngjyra e semaforit llogaritet automatikisht sipas parimit të përgjithshëm "vlere positive ndryshimi = jeshile". Kjo rregull zbatohet njëtrajtësisht për të gjithë treguesit dhe mund të japë vizualisht ngjyrë jeshile edhe në raste kur rezultati real është negativ ose e kundërta ngjyre te kuqe kur rezultati real është pozitiv.

Në veçanti, për disa tregues me logjikë të përmbysur, ulja e vlerës absolute përfaqëson përmirësim të performancës. Këtu përfshihen, ndër të tjera:

- Detyrimet e prapambetura (rënia tregon përmirësim financiar).
- Shpenzimet administrative (ulja tregon efikasitet).

## QELLIMI I RAPORTIT

Raporti i Performancës 2025 synon të ofrojë një pasqyrë të qartë dhe të strukturuar mbi performancën e bashkisë në 11 fusha funksionale. Ky raport përdoret për të ndihmuar vendimmarrjen e bazuar në të dhëna, për të forcuar transparencën dhe llogaridhënien, si dhe për të mundësuar krahasimin ndërmjet bashkive në nivel kombëtar. Ky raport është përgatitur nga Bashkia Librazhd, i mandatuar nga Kryetari i Bashkisë në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015, Neni 33, si dhe në kuadër të Sistemit Kombëtar të Matjes së Performancës (SMP 2025).

## VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI BASHKINË

### Vështrim i Përgjithshëm mbi Bashkinë Librazhd

Bashkia Librazhd mbetet një nga bashkitë me territor të gjerë dhe topografi të larmishme në qarkun e Elbasanit, ku pjesa më e madhe e zonës është malore e kodrinore dhe përfshin një kombinim të fshatrave të vegjël të shpërndarë dhe një qendër të vetme urbane. Pozicionimi përgjatë korridorit nacional Elbasan–Korçë e vendos Librazhdin në një nyje të rëndësishme të qarkullimit, por njëkohësisht e ekspozon qytetin ndaj sfidave strukturore si depopullimi, papunësia sezonale dhe migrimi i të rinjve.

### DEMOGRAFIA DHE DINAMIKA SOCIALE

Trendet demografike të viteve të fundit tregojnë një **ulje të popullsisë së qëndrueshme**, sidomos në zonat e thella rurale, duke ndikuar drejtpërdrejt në kërkesën për shërbime publike, arsimim, mbështetje sociale dhe fuqi punëtore. Megjithatë, Librazhdi vazhdon të jetë një bashki me komunitet aktiv, me tradita të forta dhe potencial për t'u orientuar drejt modeleve të reja të zhvillimit rural, turizmit natyror, shfrytëzimit të burimeve pyjore dhe vlerave mjedisore.

### EKONOMIA DHE BURIMET VENDORE

Ekonomia vendore bazohet kryesisht në bujqësi, blegtori, pyje, aktivitet tregtar dhe emigracion. Shërbimet publike përbëjnë një pjesë të rëndësishme të punësimit lokal. Në vitin 2025, Bashkia Librazhd ka treguar **stabilitet fiskal dhe disiplinë të mirë buxhetore**, me rritje të të ardhurave të veta për frymë, ekzekutim të lartë buxhetor dhe investime të qëndrueshme në shërbimet bazë. Ulja e detyrimeve dhe optimizimi i shpenzimeve të personelit tregojnë për një administrim më të orientuar drejt eficiencës.

### INFRASTRUKTURA DHE SHËRBIMET PUBLIKE

Rrjeti i shërbimeve publike mbulon të gjithë territorin, por **shpërndarja e popullsisë në zona të largëta malore** ka krijuar sfida për ofrimin e rregullt të shërbimeve si:

- menaxhimi i mbetjeve në fshatra të shpërndarë,
- mirëmbajtja e rrugëve rurale,
- shërbimet e ujitjes dhe kullimit,
- menaxhimi i emergjencave dhe zjarreve në zona pyjore,
- mbështetja sociale për familjet e cenueshme.

Megjithatë, bashkia ka ruajtur **stabilitet në funksionet e detyruara**, ka përmirësuar proceset e koordinimit me njësitë administrative dhe ka avancuar në përdorimin e Sistemit të Matjes së Performancës (SMP) për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave.

---

## MJEDISI DHE POTENCIALI ZHVILLIMOR

Librazhdi ka një potencial të lartë natyror falë:

- Parkut Kombëtar Shebenik–Jabllanicë,
- zonave të mbrojtura me biodiversitet të pasur,
- resurseve të ujit dhe pyjeve,
- mundësive për turizëm malor, ecje, agroturizëm dhe sporte natyrore.

Ky potencial mbetet i nënshfrytëzuar, por ofron mundësi për zhvillim ekonomik, punësim dhe orientim të bashkisë drejt modeleve të qëndrueshme të ekonomisë së gjelbër.

---

## QEVERISJA VENDORE DHE PËRFSHIRJA QYTETARE

Në 2025, bashkia ka treguar përmirësim në disa dimensione të qeverisjes vendore, përfshirë transparencën, raportimin financiar dhe realizimin e shërbimeve bazë. Megjithatë, sfida kryesore mbetet **rritja e përfshirjes qytetare, forcimi i konsultimeve publike dhe rritja e kapaciteteve të njësive administrative**, të cilat shpesh operojnë me staf minimal dhe mungesë logjistike.

---

## PËRMBLEDHJE

Librazhdi është një bashki me **sfida strukturore**, por edhe me **mundësi të qarta zhvillimi**. Depopullimi, terreni malor dhe kapacitetet e kufizuara administrative ndikojnë në cilësinë e shërbimeve, por nga ana tjetër financat e qëndrueshme, pozita gjeografike, potenciali natyror

dhe stabiliteti institucional krijojnë bazën për një orientim më të fortë drejt zhvillimit të qëndrueshëm rural, turizmit natyror dhe përmirësimit të shërbimeve për qytetarët.

## TË DHËNAT E PËRGGJITHSHME TË BASHKISË

E DHËNA	Viti 2025
Popullësia totale nën administrimin e bashkisë	42,811
Sipërfaqja totale e bashkisë (në km <sup>2</sup> )	793,36
Sipërfaqe publike e bashkisë në km <sup>2</sup>	2km <sup>2</sup>
Sipërfaqja e njësive administrative në total	791,36
Sipërfaqe totale e fondit pyjor dhe kullosor(në ha)	3,4520
Sipërfaqja e tokës bujqësore (në ha)	9678
Numri total i njësive administrative të bashkisë	7
Numri i fshatrave	52
Punonjës të bashkisë në total	440
Numri total i punonjëseve femra të bashkisë	213
Numri total i punonjësve meshkuj të bashkisë	227
Numri total i punonjësve që punojnë për administratën e bashkisë	440

# SHERBIME PUBLIKE VENDORE

Ky kapitull paraqet performancën e bashkisë në ofrimin e shërbimeve publike vendore, të cilat përbëjnë thelbin e përgjegjësisë të saj sipas Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Në këtë kuadër, janë trajtuar gjashtë fusha kryesore të aprovuara edhe në kuadër të raportit kombëtar të performancës bashkiake, që përfshijnë gjithsej 10 funksione: arsimit parauniversitar (ku hyjnë çerdhet, arsimi parashkollor dhe infrastruktura e godinave arsimore), ujitja dhe kullimi, administrimi i pyjeve dhe kullotave, menaxhimi i mbetjeve, mbrojtja nga zjarri, mbrojtja civile, si dhe mbrojtja sociale, e cila përfshin katër shërbime të detyrueshme sipas nenit 24 të ligjit.

Matja e performancës në këto fusha bazohet në tregues të standardizuar sipas SMP Kombëtar, tregues të tjere vendor që janë përzgjedhur nga bashkia, si dhe nën-tregues të detajuar, të cilët ofrojnë një pasqyrë të qartë mbi aksesin e qytetarëve në shërbime, cilësinë dhe kapacitetet e tyre, si dhe barazinë në ofrim ndërmjet grupeve të ndryshme shoqërore. Përmes këtij sistemi, bashkia ka mundësi të identifikojë përparimet e arritura, sfidat e mbetura dhe nevojat për përmirësim në ofrimin e shërbimeve themelore për komunitetin.



# ARSIMI PARANIVERSITAR

## PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM

Arsimi parauniversitar në nivel vendor përfshin shërbimet e arsimit të hershëm (çerdhe dhe kopshte), arsimin bazë 9-vjeçar dhe arsimin e mesëm të përgjithshëm. Kompetencat për administrimin dhe zhvillimin e këtij sektori janë të deleguara te njësitë e vetëqeverisjes vendore sipas Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Funkcionet kryesore përfshijnë ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore (23.11) si dhe administrimin e sistemit parashkollor (23.12).

## ANALIZA E SHËRBIMIT

### **Analiza e shërbimit (e rishkruar)**

Në vitin 2025, Bashkia Librazhd paraqet një performancë të qëndrueshme në aspektin e mirëmbajtjes së infrastrukturës arsimore, ku 100% e çerdheve, kopshteve dhe shkollave 9-vjeçare publike rezultojnë të mirëmbajtura, pa ndryshim krahasuar me vitin 2024. Ky tregues reflekton stabilitet institucional dhe përmbushje të detyrimeve bazë në funksionin e administrimit të godinave arsimore.

Në aspektin e kapaciteteve dhe organizimit të procesit mësimor, vihet re një rritje e lehtë e raportit nxënës/mësues në arsimin bazë (nga 7.45 në 7.59), që lidhet kryesisht me uljen e numrit të mësuesve dhe nxënësve, por pa ndikuar ndjeshëm në cilësinë e raportit. Ndërkohë, numri mesatar i nxënësve për klasë në arsimin 9-vjeçar dhe në kopshte ka shënuar rënie të lehtë, duke reflektuar presion më të ulët mbi klasat dhe një potencial për përmirësim të cilësisë së mësimdhënies.


Në drejtim të investimeve, është realizuar rikonstruksioni i një shkolle 9-vjeçare gjatë vitit 2025, ndërsa në sektorin parashkollor nuk rezultojnë ndërhyrje të reja infrastrukturore. Kjo tregon një progres të kufizuar në përmirësimin e mëtejshëm të infrastrukturës, sidomos në arsimin e hershëm.

Nga ana e aksesit, treguesit e regjistrimit në çerdhe dhe kopshte mbeten në nivel maksimal (100%), duke reflektuar mbulim të plotë të kërkesës për këto shërbime në territorin e bashkisë. Megjithatë, mungesa e sektorit privat (0 institucione private) tregon një ofertë tërësisht publike dhe mungesë diversifikimi të shërbimit.

Një zhvillim pozitiv vihet re në rritjen e numrit të prindërve të informuar për prindërimin pozitiv (78 → 81), duke reflektuar forcim të komponentit social dhe ndërgjegjësues në arsimin e hershëm.

Nga ana tjetër, disa tregues sinjalizojnë sfida strukturore. Numri i godinave arsimore ka pësuar rënie (52 → 50), në linjë me tendencat demografike dhe rënien e popullsisë shkollore. Gjithashtu, mungesa e të dhënave për shpenzimet për institucionet arsimore dhe për konviktet nuk lejon një vlerësim të plotë të efikasitetit financiar të sektorit.

Në përgjithësi, sektori i arsimit parauniversitar në Bashkinë Librazhd karakterizohet nga stabilitet në mbulimin e shërbimeve dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës, por me sfida të lidhura me investimet e kufizuara, mungesën e diversifikimit të ofertës dhe ndikimin e rënies demografike në strukturën e sistemit arsimor.



#### B) Lista e detajuar

Lloj	Emri	Njësia Matëse	2024	2025	Trend i	Simbo l	% Ndryshimi	Sema or
Tregues	Çerdhe të mirëmbajtura kundrejt	%	100.0	100.0	0.00	→	0.00%	📄

	numrit total të çerdheve publike		0	0				
Tregues	Kopshteve të mirëmbajtura kundrejt numrit total të kopshteve publike	%	100.0 0	100.0 0	0.00	→	0.00%	?
Tregues	Shkolla 9 vjeçare të mirëmbajtura, kundrejt numrit total të shkollave 9 vjeçare publike	%	100.0 0	100.0 0	0.00	→	0.00%	?
Tregues	Raporti nxënës/mësues në shkolla 9 vjeçare	nxënës/ mësues	7.45	7.59	0.14	↑	1.93%	?
Tregues	Numri mesatar i nxënësve në një klasë të shkollës 9 vjeçare publike	nxënës/k lasë	10.96	10.72	-0.24	↓	- 2.18%	?
Tregues	Numri mesatar i fëmijëve në një klasë kopshti publik	nxënës/k lasë	15.36	15.21	-0.15	↓	- 0.97%	?
Tregues	Punonjës mbështetës për shkollë 9 vjeçare	punonjës mbështete tës/shkol lë 9 vjeçare	0.38	0.40	0.02	↑	5.00%	?
Tregues	Shkolla 9 vjeçare të rikonstruara	numër	0.00	1.00	1.00	↑	0.00%	?
Tregues	Kopshte të rikonstruara	numër	0.00	0.00	0.00	→	0.00%	?
Tregues	Raporti i shpenzimeve për institucionet e arsimit parauniversitar kundrejt numrit total të institucioneve (Mijë Lekë/institucion)	Mijë Lekë/inst itucion	0.00	0.00	0.00		0.00%	○
Tregues	Kopshte ku janë ngritur këshillat e prindërve kundrejt numrit total të kopshteve publike	%	100.0 0	100.0 0	0.00	→	0.00%	?

Tregues	Shpenzime kundrejt numrit total të studentëve të akomoduar në konvikte	Mijë Lekë/stu dent	0.00	0.00	0.00		0.00%	○
Tregues	Numri I prinderve te informuar ne lidhje me prinderimin pozitiv per femijet 0-3 vjec	numër	78.00	81.00	3.00	↑	3.85%	?
Tregues	Shkalla e regjistrimit në çerdhe publike	nxënës/mësues	100.0 0	100.0 0	0.00	→	0.00%	?
Tregues	Shkalla e regjistrimit në kopshte publike dhe private	%	100.0 0	100.0 0	0.00	→	0.00%	?
Tregues	Plani Vendor i Arsimit Parauniversitar	Po/Jo	1.00	1.00	0.00	→	0.00%	?
Tregues	Godina Arsimore sipas nivelit arsimor	numër	52.00	50.00	-2.00	↓	- 3.85%	?
Nëntregues	Godina Arsimore publike sipas nivelit arsimor	numër	52.00	50.00	-2.00	↓	- 3.85%	?
Nëntregues	Godina Arsimore private sipas nivelit arsimor	numër	0.00	0.00	0.00	→	0.00%	?
Nëntregues	Shkalla e regjistrimit në kopshte publike	%	100.0 0	100.0 0	0.00	→	0.00%	?
Nëntregues	Shkalla e regjistrimit në kopshte private	%	0.00	0.00	0.00	→	0.00%	?
Nëntregues	Raporti fëmijë-mësues në kopshte publike	nxënës/mësues	9.50	9.53	0.03	↑	0.35%	?

C) Shtojcë: Të dhënat burim

Kodi I të dhënës	E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
------------------	---------	------------	------------	------------	---------------

D01	Numri i çerdheve publike të mirëmbajtuara	1	1	1	Numër
D02	Numri i kopshteve publike të mirëmbajtuara	3	3	3	Numër
D03	Numri i shkollave 9 vjeçare publike të mirëmbajtuara	40	42	40	Numër
D04	Numri i nxënësve të regjistruar në shkolla 9 vjeçare publike	2539	2346	2209	Numër
D05	Numri i mësuesve që japin mësim në shkolla 9 vjeçare publike	343	315	291	Numër
D06	Numri i klasave të kopshteve publike	49	47	47	Numër
D07	Numri i klasave të shkollave 9 vjeçare publike	219	214	206	Numër
D08	Numri i ndërtesave publike të arsimit bazë të rikonstruktura	1	0	1	Numër
D09	Numri i ndërtesave publike të arsimit parashkollor të rikonstruktura	0	0	0	Numër
D10	Numri i stafit mbështetës në arsimin bazë në shkollat 9 vjeçare publike	18	16	16	Numër
D11	Shpenzime për insitucione publike të arsimit parauniversitar: çerdhe, kopshte, shkolla 9 vjeçare, shkolla të mesme të përgjithshme				Mijë Lekë
D12	Numri i kopshteve publike ku janë ngritur këshillat e prindërve	3	3	3	Numër
D13	Numri i stafit mbështetës në shkolla të mesme të përgjithshme publike	10	10	17	Numër
D14	Totali i shpenzimeve (Operative dhe mirëmbajtje si edhe investime) për konviktet e arsimit profesional				Mijë Lekë

D15	Numrit total të studentëve të akomoduar në konvikte të arsimit profesional	0	0	0	Numër
D16	Numri i nxënësve të regjistruar në shkolla të mesme të përgjithshme publike	962	882	907	Numër
D17	Numri i klasave në shkolla të mesme të përgjithshme publike	42	40	41	Numër
D18	Numri i nxënësve të akomoduar në konvikte të arsimit profesional	0	0	0	Numër
D19	Numri i dhomave të konvikteve të arsimit profesional	0	0	0	Numër
D20	Numri i konvikteve funksionale	0	0	0	Numër
D21	Numri i prindërve të informuar në lidhje me prindërimin pozitiv për fëmijet 0-3 vjeç	83	78	81	Numër
D22	Numri i personelit të çerdheve publike	24	24	25	Numër
D23	Numri i personelit të trainuar të çerdheve publike	0	0	0	Numër
D24	Numri i çerdheve publike të furnizuara me material didaktik	0	0	0	Numër
D25	Numri i fëmijëve të moshës nga 6 muaj-3 vjeç në bashki	83	78	81	Numër
D26	Numri i fëmijëve të moshës 6 muaj deri në 3 vjeç të regjistruar në çerdhe publike	83	78	81	Numër
D27	Numri i fëmijëve të moshës nga 3-6 vjeç në bashki	739	722	715	Numër
D28	Numri i fëmijëve të moshës 3-6 vjeç që frekuentojnë kopshtet publike	739	722	715	Numër
D29	Numri i fëmijëve të moshës 3-6 vjeç që	0	0	0	Numër

	frekuentojnë kopshtet private				
D30	Numri i edukatorëve në kopshte publike	77	76	75	Numër
D31	Numri i edukatorëve në kopshte private	0	0	0	Numër
D32	Numri i çerdheve publike në bashki	1	1	1	Numër
D33	Numri i çerdheve private në bashki	0	0	0	Numër
D34	Numri i kopshteve publike në bashki	3	3	3	Numër
D35	Numri i kopshteve private në bashki	0	0	0	Numër
D36	Numri i shkollave 9-vjeçare publike në bashki	45	42	40	Numër
D37	Numri i shkollave 9-vjeçare private në bashki	0	0	0	Numër
D38	Numri i shkollave të mesme të përgjithshme publike në bashki	6	6	6	Numër
D40	Plani vendor i Arsimit Parauniversitar, I miratuar ose zbatuar	1	1	1	



## MENAXHIMI I MBETJEVE

### A) PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Në fushën e menaxhimit të mbetjeve, bashkia paraqet një situatë të qëndrueshme në nivel të përgjithshëm, por me sfida të dukshme në zonat rurale dhe në mbulimin e kostove të shërbimit. Gjatë vitit 2025, disa tregues kanë mbetur të pandryshuar krahasuar me vitin 2024, ndërsa disa të tjerë kanë shënuar luhatje të lehta.

Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në total mbetet në nivel rreth 58%, duke reflektuar një shërbim ende të pa shtrirë plotësisht në gjithë territorin. Ndërkohë, gjenerimi i mbetjeve për banor ka shënuar një rritje të lehtë, duke treguar një tendencë të qëndrueshme në prodhimin e mbetjeve.

Një problem i rëndësishëm mbetet mbulimi i kostove të shërbimit nga tarifat, i cili qëndron në nivel të ulët (rreth 43%), duke treguar varësi nga financimi publik.

---

## B) ANALIZA E TREGUESVE KRYESORË

- **Mbulimi i popullsisë me shërbimin e mbetjeve (urbane/rurale)**  
Qëndron i pandryshuar në 57.94%, duke treguar mungesë zgjerimi të shërbimit në total.
- **Mbetjet e gjeneruara për banor**  
Ka një rritje të lehtë nga 6.69 në 6.72 kg/banor (+0.43%), duke reflektuar stabilitet në prodhimin e mbetjeve.
- **Mbulimi i kostos së shërbimit nga tarifa**  
Qëndron në 42.81%, pa ndryshim, duke treguar vështirësi në vetë-financimin e shërbimit.
- **Plani vendor i menaxhimit të mbetjeve**  
Është i miratuar dhe në zbatim, por pa progres të mëtjshëm në përmirësim apo zgjerim.

---


## C) ANALIZA URBANE DHE RURALE

- **Zonat urbane**  
Mbulimi i shërbimit është i lartë në 85.71%, duke treguar një performancë të mirë dhe shërbim relativisht të konsoliduar.
- **Zonat rurale**  
Ka një ulje të ndjeshme nga 36.54% në 30.16% (-17.46%), duke sinjalizuar përkeqësim të mbulimit dhe nevojë për ndërhyrje urgjente.

---

## D) TË DHËNA MBËSHTETËSE

- Popullsia totale ka shënuar një rënie të lehtë (43,067 → 42,811 banorë).
- Sasia totale e mbetjeve të gjeneruara është ulur lehtë, por mbetet e qëndrueshme (~287,708 kg).
- Të ardhurat nga tarifa e shërbimit kanë rënë krahasuar me periudhat e mëparshme, ndërsa shpenzimet kanë mbetur më të larta se të ardhurat.
- Numri i fshatrave të mbuluara është rritur nga 15 në 19, por kjo nuk ka mjaftuar për të përmirësuar përqindjen e mbulimit në zonat rurale.



### B) Lista e detajuar

Lloj	Emri	Njësia Matëse	2024	2025	Trendi	Simboli	% Ndryshimi	Semantor
Tregues	Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zonat urbane/rurale	%	57.94	57.94	0.00	→	0.00%	?
Tregues	Mbetjet e gjeneruara si kg/banor	kg/banor	6.69	6.72	0.03	↑	0.43%	?
Tregues	Mbulimi kostos së menaxhimit të mbetjeve nga tarifa e shërbimit	%	42.81	42.81	0.00	→	0.00%	?
Tregues	Plani vendor i menaxhimit të mbetjeve i miratuar ose në zbatim	Numër	1.00	1.00	0.00	→	0.00%	?
Nëntregues	Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zonat urbane	%	85.71	85.71	0.00	→	0.00%	?
Nëntregues	Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zonat rurale	%	36.54	30.16	-6.38	↓	-17.46%	?

C) Shtojcë: Të dhënat burim

Kodi I të dhënës	E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
D54	Numri njësive administrative qendër (qytete) të mbuluar me shërbimin e mbetjeve	6	6	6	Numër
D55	Numri njësive administrative qendër (qytete) të bashkisë	7	7	7	Numër
D56	Numri fshtrave të mbuluar me shërbimin e mbetjeve	15	19	19	Numër
D57	Numri fshatrave në territorin e bashkisë	63	63	63	Numër
D58	Sasia e mbetjeve të gjeneruara gjithsej	296864	287708	287708	Kg
D59	Të ardhurat gjithsej nga tarifa e shërbimit të mbetjeve	17550	16616	16616	mijë Lekë
D60	Shpenzime gjithsej për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve	37930	38815	38815	mijë Lekë
D61	Plani i miratuar ose zbatuar gjatë vitit të raportimit	1	1	1	Cilësore (Po=1/Jo=0)
D52	Popullsia e përgjithshme e bashkisë	43067	42993	42811	Numër

Kategoria

Arritje (2025)

Përshkrimi

Stabilitet në mbulimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve (57.94%).  
Zgjerim i shërbimit në fshatra (15 → 19).  
Funksionim i Planit Vendor të

Sfida

Menaxhimit të Mbetjeve. Mbulim i lartë në zonat urbane (85.71%).

Mbulim i ulët dhe në rënie në zonat rurale (36.54% → 30.16%). Mbulim total i pandryshuar (57.94%). Nivel i ulët i mbulimit të kostove nga tarifat (42.81%). Diferencë e theksuar urbane–rurale. Efikasitet financiar i kufizuar dhe varësi nga buxheti.

Objektiva për 2026

Rritje e mbulimit total mbi 60%.  
Rikuperim i zonave rurale në 40–45%.  
Përmirësim i mbulimit të kostos mbi 50%.  
Zgjerim i shërbimit në fshatra dhe rritje e frekuencës së grumbullimit. Forcim i planit vendor dhe monitorimit. Rritje e ndërgjegjësimit për ndarjen dhe reduktimin e mbetjeve.



## MBROJTJA NGA ZJARRI

### **Përshkrim i përgjithshëm:**


Bashkitë kanë përgjegjësi për garantimin e shërbimit zjarrfikës në nivel vendor dhe për administrimin e strukturave përkatëse të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit. Ky funksion synon të sigurojë reagim të shpejtë dhe efektiv në raste emergjencash, si dhe të ndërtojë kapacitete vendore për parandalimin e zjarreve në mjedise urbane, rurale dhe pyjore. Përgjegjësitë e bashkive përfshijnë operimin dhe mirëmbajtjen e njësive zjarrfikëse, organizimin e shërbimeve parandaluese, si dhe bashkëpunimin me strukturat qendrore për raste që tejkalojnë kapacitetet vendore. Bashkitë gjithashtu angazhohen në edukimin e komunitetit dhe trajnimin e stafit për reagim dhe menaxhim të rreziqeve nga zjarret.

## ANALIZA E SHËRBIMIT

Në vitin 2025, Bashkia Librazhd ka shënuar një rënie të lehtë në treguesit e mbulimit të shërbimit zjarrfikës, pavarësisht rritjes së numrit total të punonjësve dhe mjeteve. Numri i zjarrfikësve për 1,500 banorë ka rënë nga 0.56 në 0.54 (-2.70%), ndërsa automjetet zjarrfikëse për 10,000 banorë kanë rënë nga 0.70 në 0.66 (-5.65%).

Megjithëse në vlerë absolute numri i punonjësve është rritur në 22 dhe mjetet funksionale në 4, rritja e popullsisë ka ndikuar në uljen e raportit të mbulimit. Kjo tregon se kapacitetet operative janë zgjeruar, por jo në të njëjtin ritëm me nevojat demografike të bashkisë.

Shërbimi mbetet funksional në ndërhyrje emergjente, por vazhdon të karakterizohet nga kufizime në mbulim territorial dhe mungesë e theksuar e mekanizmave të parandalimit aktiv, veçanërisht në zonat rurale dhe pyjore me risk të lartë. Kërkohet forcim i mëtejshëm i kapaciteteve logjistike, rritje e efektivitetit të shpërndarjes së mjeteve dhe përmirësim i planifikimit për menaxhimin e emergjencave në nivel vendor.



### B) Lista e detajuar

Lloj	Emri	Njësia	2024	2025	Trend	Simbo	% Ndry	Sem
------	------	--------	------	------	-------	-------	--------	-----

		Matëse					himi	or
Tregues	Zjarrëfikës për 1,500 banorë	punonjës /1500 banorë	0.56	0.54	-0.02	↓	- 2.70%	☒
Tregues	Automjete zjarrëfikëse për 10,000 banorë	mjete/10 000 banorë	0.70	0.66	-0.04	↓	- 5.65%	☒
Nëntregues			0.00	0.00	0.00		0.00%	○

C) Shtojcë: Të dhënat burim

Kodi I të dhënës	E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
D51	Numri i punonjësve zjarrëfikës në bashki	16	16	22	Numër
D52	Popullsia e përgjithshme e bashkisë	43067	42993	60754	Numër
D53	Numri i mjeteve zjarrëfikëse funksionale në bashki	3	3	4	Numër
D50	Numri i punonjësve për menaxhimin e fondit pyjor dhe kullosor	15	15	12	Numër

Kategoria

Arritje (2025)

Përshkrimi

Rritje e kapaciteteve absolute të shërbimit zjarrëfikës me 22 punonjës dhe 4 mjete funksionale. Përmirësim i bazës materiale dhe forcim i strukturës operative të ndërhyrjes. Funksionim i vazhdueshëm i shërbimit emergjent në territorin e bashkisë dhe aftësi për reagim

Sfida

në raste zjarresh urbane dhe rurale.

Rënie e treguesve të mbulimit për shkak të rritjes së popullsisë (0.56 → 0.54 zjarrfikës/1,500 banorë dhe 0.70 → 0.66 mjete/10,000 banorë). Mbulim ende i kufizuar në raport me territorin malor dhe zonat pyjore me risk të lartë. Mungesë e mekanizmave të qëndrueshëm të parandalimit dhe patrullimit sezonal. Efikasitet i kufizuar në raport me nevojat në rritje.

Objektiva për 2026

Rritje e raportit të zjarrfikësve dhe mjeteve për 1,500/10,000 banorë mbi nivelin e vitit 2024. Forcim i kapaciteteve logjistike dhe shtim i mjeteve funksionale. Zhvillim i sistemeve parandaluese dhe patrullimit sezonal në zonat me risk të lartë. Përmirësim i reagimit të shpejtë dhe rritje e bashkëpunimit ndërinstytucional për menaxhimin e emergjencave.



## ADMINISTRIMI I PYJEVE DHE KULLOTAVE

**Përshkrim i përgjithshëm:** Funkzioni për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave është pjesë e kompetencave të bashkisë sipas Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe kuadrit ligjor sektorial për pyjet dhe fondin kullosor. Ky funksion përfshin planifikimin, administrimin dhe mbrojtjen e fondit pyjor dhe kullosor në territorin e bashkisë, hartimin dhe zbatimin e planeve të mbarështimit, si

dhe garantimin e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore. Qëllimi i tij është ruajtja e ekuilibrit ekologjik, rritja e mbulimit me plane menaxhimi dhe forcimi i kapaciteteve për administrimin efektiv të fondit pyjor dhe kulllosor.

### **ANALIZA E SHËRBIMIT**

Në vitin 2024, menaxhimi i fondit pyjor dhe kulllosor paraqet një situatë përgjithësisht të qëndrueshme, me përmirësim të dukshëm në mbulimin me plane mbarështimi. Shkalla e sipërfaqes së fondit pyjor dhe kulllosor të mbuluar me plan është rritur nga 15.44% në 17.74%, duke shënuar një rritje prej 14.84%, që tregon progres në planifikimin dhe formalizimin e menaxhimit të këtij burimi natyror. Ky është tregues pozitiv për përmirësimin e qasjes së bashkisë drejt menaxhimit të qëndrueshëm dhe të strukturuar të pyjeve dhe kullotave.


Nga ana tjetër, numri i punonjësve për menaxhimin e fondit pyjor dhe kulllosor ka mbetur i pandryshuar (11 punonjës), ndërsa treguesi për punonjës për 1,000 hektarë ka mbetur në nivel të ulët dhe të pandryshuar (0.29), duke sinjalizuar mungesë rritjeje të kapaciteteve njerëzore përballë një fondi pyjor dhe kulllosor relativisht të madh. Kjo tregon se përmirësimet në planifikim nuk janë shoqëruar me forcim të burimeve njerëzore, çka mund të ndikojë në efikasitetin e zbatimit në terren.

Plan Vendor i Mbarështimit është i miratuar dhe në zbatim (vlera 1), duke reflektuar stabilitet institucional në nivel planifikimi, por ende me hapësirë për zgjerim të mbulimit dhe rritje të efikasitetit të zbatimit në terren. Sipërfaqja totale e fondit pyjor dhe kulllosor ka mbetur pothuajse e pandryshuar (rreth 37,804 ha), çka tregon mungesë ndryshimesh strukturore në territor, ndërsa rritja e sipërfaqes së mbuluar me plan mbetet ende e kufizuar në raport me potencialin ekzistues.

Në përgjithësi, sektori paraqet përmirësime në aspektin e planifikimit, por kërkon forcim të kapaciteteve njerëzore dhe zgjerim të mbulimit me plane mbarështimi për të siguruar menaxhim më efektiv dhe të qëndrueshëm të fondit pyjor dhe kulllosor.

Arritje (2025)	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Rritje e sipërfaqes së fondit pyjor dhe kulllosor të mbuluar me plane mbarështimi nga 15.44% në 17.74% (+14.84%).</li> <li>- Plan Vendor i Mbarështimit i miratuar dhe në zbatim (vlera 1).</li> <li>- Stabilitet i sipërfaqes totale të fondit pyjor dhe kulllosor (rreth 37,804 ha).</li> <li>- Numër i qëndrueshëm i punonjësve (11).</li> </ul>
Sfidat	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nivel i ulët i mbulimit me plane mbarështimi (17.74%).</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kapacitete të kufizuara njerëzore (0.29 punonjës/1000 ha).</li> <li>- Nevojë për forcim të zbatimit dhe monitorimit në terren.</li> <li>- Mungesë zgjerimi të ndjeshëm të mbulimit planifikues.</li> </ul>
Objektivat për 2026	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Rritja e mbulimit me plane mbarështimi mbi 20%.</li> <li>- Forcimi i kapaciteteve njerëzore dhe monitorimit.</li> <li>- Përmirësimi i zbatimit të planeve në terren.</li> <li>- Zgjerim i përdorimit të mjeteve digjitale për menaxhim.</li> </ul>



#### B) Lista e detajuar

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera (viti i kaluar)	Vlera (viti aktual)	Trendi	Simboli	% Ndryshimi	Semanti
Tregues	Plan Vendor Mbarështimi I miratuar ose zbatuar	Cilësore (Po/Jo)	1.00	1.00	0.00	→	0.00%	?
Tregues	Shkalla e pajisjes me plane mbarështimi	%	15.44	17.74	2.29	↑	14.84 %	?

Tregues	Punonjës për 1,000 hektarë	punonjës / 1000 ha	0.29	0.29	0.00	↓	0.00%	☒
Nëntregues			0.00	0.00	0.00		0.00%	○

**C) Shtojcë: Të dhënat burim**

Kodi I të dhënës	Kodi i Treguesit	Përdorur në treguesit	E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
D47	275A01	275A01	Plan Vendor Mbarështimi I miratuar ose zbatuar	1	1	1	Cilësore (Po=1/Jo=0)
D48	275A02	275A02, 275A03	Sipërfaqja gjithsej e fondit pyjor dhe kullosor në bashki	37803	37803	37804	Hektarë
D49	275A02	275A02	Sipërfaqja e fondit pyjor dhe kullosor e mbuluar me plan mbarështimi	5838.4	5838.4	6704.81	Hektarë
D50	275A03	275A03	Numri i punonjësve për menaxhimin e fondit pyjor dhe kullosor	11	11	11	Numër



# MBROJTJA SOCIALE

## **Përshkrim i përgjithshëm:**

Bashkitë janë përgjegjëse për krijimin, administrimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale vendore për individët dhe familjet në nevojë, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara, fëmijët pa përkujdesje prindërore, të moshuarit, viktimat e dhunës dhe trafikimit, si dhe grupet e tjera vulnerabël. Shërbimet përfshijnë ndihma financiare dhe në natyrë, mbështetje për strehim dhe përfshirje sociale, si dhe funksionimin e qendrave ditore apo rezidenciale. Qëllimi i tyre është të lehtësojnë jetesën dhe të nxisin integrimin e qytetarëve në komunitet. Ndër shërbimet kryesore përfshihen ndihma ekonomike për familjet në nevojë, strehimi social, shërbimet komunitare, mbështetja për personat me aftësi të kufizuara dhe mekanizmat për trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Bashkitë bashkëpunojnë gjithashtu me OJF dhe aktorë të tjerë për ofrimin e këtyre shërbimeve.

## **ANALIZA E SHËRBIMIT**

Në vitin 2025, Bashkia Librazhd ka shënuar një ulje të ndjeshme në mbulimin e ndihmës ekonomike, ku përqindja e familjeve përfituese ka rënë nga 98.9% në 91.07%, duke reflektuar një reduktim të lehtë të efikasitetit në raport me vitin paraardhës.

Në fushën e strehimit social, vihet re një rënie shumë e theksuar e shkallës së miratimit (nga 62.04% në 31.98%), çka tregon kufizime të konsiderueshme në kapacitetet dhe burimet për përballimin e kërkesave në rritje për strehim.

Numri i qendrave sociale komunitare mbetet i pandryshuar në nivel 0.70 për 10,000 banorë, duke treguar stabilitet në infrastrukturën ekzistuese të shërbimeve. Nga ana tjetër, të dhënat për Mekanizmin e Koordinuar të Referimit për vitin 2025 nuk janë të plota, duke mos lejuar vlerësim të plotë të vazhdimësisë së shërbimeve për rastet e dhunës në familje.


Në mënyrë pozitive, vërehet një rritje e lehtë e përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në shërbime të integruara sociale (nga 15.93% në 16.19%), duke treguar përmirësim gradual në mbështetjen e këtij grupi.

Plani Social Vendor mbetet i miratuar dhe në fuqi, duke siguruar vazhdimësinë e kornizës së politikave sociale në nivel vendor.

## **Arritje**

